



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 1833 / 3 Prot.

Tiranë, më 31/12/2013

Lënda: Mbi kundërvajtjen administrative të kontrolluesit, "Press Point Albania" Tiranë.

VENDIM
Nr. 07 , datë 31/12/2013

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr. 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Hetim Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, "Press Point Albania", me adresë: Gjokaj Auto-City, Autostrada Tiranë-Durrës, Km.8, Tiranë, Vorë.

KONSTATOVA

Sipas ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", ju keni cilësinë e Kontrolluesit, pra përgjegjësini për përpunimin e të dhënave personale dhe si i tillë keni detyrimin të zbatoni të gjitha kërkesat e këtij ligji dhe në mënyrë të veçantë të detyrimit të parashikuar në nenin 21 të tij.

Në pikën 1 të nenit 21 të ligjit të mësipërm parashikohet se: "*Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë*". Ndërsa në nenin 22 saktësohet përmbajtja e të dhënave që përpunoni, të cilat duhet t'i njoftoni tek Komisioneri.

Për zbatimin e këtij detyrimi nga ana jonë, me shkresën nr.512 prot, datë 21.01.2011, ju është dërguar një shkresë sensibilizuese me lëndë: Mbi plotësimin e detyrimit për njoftimin e përpunimit të të dhënave personale pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke ju caktuar një afat për plotësimin e këtij detyrimi datë 21.02.2011.

Gjatë inspektimit administrativ të realizuar pranë kontrolluesit në zbatim të urdhërit nr 246, datë 05.12.2013 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale u konstatua se:

Kontrolluesi, "Press Point Albania", Tiranë nuk ka kryer detyrimin ligjor për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Nuk është zbatuar, neni 21 i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të dhënave personale". Kjo, ju bë me dije

edhe kontrolluesit nëpërmjet proces verbalit të datë: 17.12.2013 i mbajtur në prani të tij.

Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të dhënave personale" është ligj i cili është botuar ne Fletore Zyrtare dhe me kalimin e afatit ligjor përkatës ligjërisht supozohet se është bërë i njohur për gjithë publikun dhe është ligjërisht i detyrueshëm për tu zbatuar nga të gjithë kontrolluesit, institucionet publike dhe private të cilëve iu drejtohet.

Nga miratimi i ligjit deri në momentin e inspektimit administrativ në zbatim të urdhërit nr. 246, datë 05.12.2013 ka kaluar një periudhë, relativisht e gjatë dhe kontrolluesi ka patur të gjithë kohën e nevojshme për tu njohur me ligjin dhe detyrimet ligjore të tij.

Në bazë të nenit 21 të ligjit nr. 9887: datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të dhënave personale", "*...Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit të njoftuar më parë*".

Gjithashtu, bazuar në nenin 25 të Ligjit, kontrolluesi nuk mund të fillojë përpunimin e të dhënave personale pa njoftuar më parë Zyrën e Komisionerit. Në këto kushte e konsiderojmë shkelje përpunimin pa njoftuar e pa u regjistruar më parë në Regjistrin Qëndror të Subjekteve Kontrolluese, të administruar nga Zyra e Komisionerit. Fakti që bërja publike, bazuar në nenin 26/2 të Ligjit, është penguar për shkak të mos njoftimit të përpunimit/eve që ju realizoni, mund të ketë penguar referencat e mundshme që subjektet specifike që ju u përpunoni të dhënat mund të kishin bërë te gjendja e përpunimit/eve që ju realizoni.

Mospërbushja e këtij detyrimi ju ngarkon me përgjegjësi administrative të parashikuar në nenin 39 pika 1 gërma "d", të ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", ku parashikohet dënimi me gjobë nga 10.000 deri në 500.000 lekë.

Për zgjedhjen e masës së gjobës Komisioneri ka parasysht shkallën e njohjes dhe masat që keni marrë për implementimin e ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Nisur sa më sipër, në zbatim të neneve 21-23, 30/2, 39/1,4; 40 e 41, të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", neneve 107-109 të K.Pr.Administrative dhe Nenit 18/a, c të Ligjit Nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për Kundërvajtjet Administrative":

VENDOSA

1. Dënimin e Kontrolluesit, me gjobë 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë për mosplotësimin e detyrimit për njoftim sipas nenit 21 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".
2. Plotësimi i detyrimit për të njoftuar që ju ngarkon ligji, të kryhet brenda një afati kohor prej 7 (shtatë) ditësh.
3. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim shndërrohet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.

Ky vendim u dha sot më datë, 31.12.2013.

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

